

Eppc kërkon një **Drejtor Shitjesh** për klientin e saj, i cili është **një ndër kompanitë më të suksesshme në treg** që ofron zgjidhje për menaxhimin e shitjeve, marketingut, logjistikës dhe distribucionit për bizneset.

Përgjegjësitë Kryesore:

1. Hartimi dhe zbatimi i një strategjie të përgjithshme të shitjeve në përputhje me strategjinë dhe objektivat e biznesit;
2. Përgatitja e planeve të veprimit për identifikimin e klientëve të rinj dhe planifikimi i mënyrës së përqsjes ndaj kontakteve të reja;
3. Zbatimi me korrektësi i kontratës me klientin ,ruajtja e marrëdhënieve afatgjata me ta;
4. Përshtatja e shërbimeve të kompanisë në përputhje me kërkesat e tregut;
5. Monitorimi dhe motivimi i ekipit të shitjeve.

Kërkesat për këtë pozicion janë:

- Diplomë Universitare në profilin e marketingut ose menaxhim biznesi;
- Përvojë e mëparshme në pozicione të ngjashme pune;
- Aftësi të mira ndërveprimi në biznes dhe shitje;
- Të jetë i aftë të punojë në mënyrë të pavarur dhe të motivojë stafin në varësi;
- Të ketë leje drejtimi automjeti;
- Të zotërojë mirë MS Office.

Të dhënat:

Pozicioni:	Drejtor Shitjesh;
Vendndodhja:	Tiranë;
Orari:	48 orë;
Raporton tek:	Drejtori i Përgjithshëm;
Pagesa:	Shumë e mirë (<i>fikse + bonuse</i>);
Kontrata:	Sipas Kodit të Punës;
Aplikimet mbyllen:	20.12.2017

Si të aplikoni:

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutemi dërgoni CV-në tuaj dhe dokumentet e tjera shoqëruese duke **përmendur pozicionin për të cilin aplikoni** në adresën e e-mail^{it}:

recruitments@eppc.al

Ju do të kontaktoheni vetëm në qoftë se CV-ja juaj dhe dokumentet shoqëruese do të kualifikohen.
Tek ne CV-ja juaj është e sigurt dhe trajtohet në konfidencialitet të plotë.